

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6942
E enjte, 13 korrik 2023
Çmimi 0.40 €

Kryetari i PDK-së,
vizitë zyrtare në Paris
dhe Bruksel | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTI TËRHIQET NGA ZOTIMET, PAJTOHET TA ZVOGËLOJË PRANINË POLICORE NË VERI, ZGJEDHJET PAS VERËS



Qeveria e Kosovës ka pranuar ta shkurtojë praninë e policisë në dhe përreth ndërtesave komunale në Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok - komuna të banuara me shumicë serbe në veri, dhe se Kosova do ta

mbështesë mbajtjen e zgjedhjeve të reja në katër komuna veriore për ta shtensionuar situatën. Pajtimi u arrit në një takim joformal në Bratislavë ndërmjet përfaqësuesit të posaçëm të BE-së për dialogun në mes të

Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak dhe zëvendëskryeministrit të Kosovës Besnik Bislimi. Qeveria e Kosovës ka njoftuar se të gjitha hapat do të finalizohen brenda një periudhë dyjavore

AKTUALE



ZELENSKY: FTESA PËR NATO DO TË ISHTE IDEALE | F. 2

DHUROHEN MJETE MBROJTËSE PËR GAZETARËT QË RAPORTOJNË NGA TERRENET ME RREZIKSHMËRI | F. 3

HAPET KONKURSI PËR 25 INSPEKTORË SHËNDETËSORË | F. 3

EKONOMI



INSPEKTORATI I TREGUT DEL NË TERREN, INSPEKTON PIKAT E SHITJES SË KARBURANTEVE | F. 8

QEVERIA MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR PROJEKTIN "REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE 10" | F. 8

SPORT



SONTE LUAJNË NË LIGËN E KONFERENCËS, GJILANI DHE DUKAGJINI | F. 10



NGUJIMI 43-DITOR I KRYETARIT TË LEPOSAVIQIT: FAMILJA S'E DI SA MUND TË ZGJASË | FAQE 7

HARADINAJ: KEQARDHJE PËR KOMUNITETIN SERB QË NUK E KISHTE KUPTUAR DREJT OFERTËN TIME PREJ KRYEMINISTRI | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky: Ftesa për NATO do të ishte ideale

VILNIUS, 12 KORRIK - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, e cilësoi "hap të rëndësishëm" thjeshtëzimin e procesit të anëtarësimit të Ukrainës në NATO. Ftesa për anëtarësim "do të ishte ideale", tha ai, por shtoi se, "së paku, mund të shoh disa pika specifike që e sjellin Ukrainën më pranë NATO-s".

Zelensky po merr pjesë në ditën e dytë të samitit të aleancës ushtarake në Vilnius të Lituanisë.

Një ditë më herët, udhëheqësit e 31 vendeve anëtare u pajtuan që Ukraina të ftohet në NATO "kur ata të bien dakord" dhe "të plotësohen kushtet". Ata u pajtuan edhe për thjeshtëzimin e procesit të anëtarësimit të saj, duke i hequr një plan anëtarësimi që kërkon përmbushjen e reformave të caktuara politike dhe ekonomike.

Duke folur në një konferencë të

përbashkët për medie me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, Zelensky tha se e kupton se përse disa aleatë të NATO-s "i druhen" anëtarësimit të Ukrainës në aleancë. "... sepse askush nuk do që të ketë një luftë botërore", tha Zelensky, vendi i të cilit ndodhet nën pushtimin rus që nga shkurti i vitit të kaluar.

Me rregulloren e saj, NATO-ja e trajton një sulm të armatosur ndaj një vendi anëtar si sulm ndaj të gjithëve - që do të thotë se aleatët janë të detyruar ta ndihmojnë njëri-tjetrin.

Stoltenbergu, duke folur përkrah Zelenskyt, tha se "Ukraina është më afër NATO-s se kurrë". Ai tha se presidenti rus Vladimir Putin e nënvlerësoi guximin e popullit të Ukrainës dhe të forcave të saj të armatosura ashtu si dhe vendosmërinë e udhëheqjes së vendit.

Stoltenbergu tha se Putini,



gjithashtu, e nënvlerësoi unitetin dhe forcën e anëtarëve të NATO-

s përballë pushtimit të tij. Ai shtoi se aleanca ushtarake do të

vazhdojë ta mbështesë Ukrainën për aq kohë sa të duhet.

OKB-ja dënon djegien e Kuranit

NJU-JORK, 12 KORRIK - Këshilli për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara votoi për t'i dënuar incidentet e fundit të djegieve të Kuranit, por shumë shtete refuzuan ta mbështetnin rezolutën, duke shprehur frikën se kjo mund ta cenojë lirinë e shprehjes.

Pavarësisht prej dënimit të diskreditimit të librit të shenjtë të islamit, votimi në këtë këshill solli më shumë ngjarje sesa unitet, me shtetet nga Evropa dhe Amerika që thanë se duhet më shumë punë që rezoluta të jetë më e fortë, përmes një vendimi unanim.

Pakistani dhe shtetet e tjera të Organizatës për Bashkëpunim Islamik iniciuan debatin dhe rezolutën pasi një refugjat irakian dogji faqe të Kuranit pranë xhamisë kryesore në Stokholm muajin e kaluar. Ky incident nxiti reagim të ashpër nga shtetet



muslimane në mbarë botën.

Këshilli për të Drejtat e Njeriut

mbështeti rezolutën e Organizatës për Bashkëpunim

Islamik duke dënuar urrejtjen fetare. Për rezolutën votuan 28

shtete, 12 ishin kundër dhe shtatë abstenuan.

Britania, Shtetet e Bashkuara, Franca, Gjermania, Kosta Rika dhe Mali i Zi votuan kundër rezolutës.

Ambasadorja e ShBA-së, Michele Taylor, kërkoi të arrihet konsensus për rezolutën. "Fatkeqësisht, shqetësimet nuk janë marrë seriozisht", tha ajo. "Më vjen keq që Këshilli nuk arriti të kishte zë të unifikuar në dënimin e atyre që të gjithë pajtohemi se janë akte të urrejtjes ndaj myslimanëve dhe, në të njëjtën kohë, të respektohet liria e shprehjes".

Në Suedi autoritetet lejojnë protestat ku digjet Kurani, duke u thirrur në lirinë e shprehjes. Edhe në janar një protestues kishte djegur Kuranin në Stokholm, incident që ishte dënuar ashpër nga shtetet muslimane.

PE-ja miraton raportin për Shqipërinë, Santos: Procesi i anëtarësimit pritet të mbyllet deri në vitin 2030

BRUKSEL, 12 KORRIK - Parlamenti Evropian ka miratuar të mërkurën raportin për Shqipërinë, i cili ka kaluar me 536 vota për, 54 kundër dhe 32 vota abstenim.

Raportuesja për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Isabel Santos, u shpreh se Shqipëria po e përmbyll në kohë rekord procesin skringing. "Ne besojmë se do të krijohen kushtet që procesi i anëtarësimit në BE të përfundojë deri në vitin 2030. E ardhmja e Shqipërisë është në BE", u shpreh raportuesja për

Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Isabel Santos.

Komisionari për zgjerimin dhe fqinjësinë e mirë, Oliver Varhelyi, u shpreh se procesi skringing pritet të mbarojë në muajin nëntor të këtij viti. "Që nga dita e parë e këtij Komisioni, Ballkani Perëndimor ka qenë prioriteti ynë. Angazhimi i përbashkët ka sjellë përparim. Që nga debati i vitit të kaluar ka një zhvillim thelbësor: gati një vit më parë ne hapëm negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë. Ky ishte një hap i madh për vendin dhe një njohje

e qartë e progresit të Shqipërisë në avancimin e agjendës së reformave të BE-së", ka theksuar Varhelyi, duke shtuar se e mirëpresin mbështetjen e jashtëzakonshme të dhënë nga Parlamenti Evropian për integrimin e Shqipërisë në BE dhe, gjithashtu, për negociatat e vazhdueshme të anëtarësimit. "Ne planifikojmë ta përfundojmë procesin skringing deri në muajin nëntor. E ardhmja e këtij vendi me siguri i përket Bashkimit Evropian dhe mendoj se ky është vendi që ka bërë më



së shumti në këtë mandat jo vetëm për ta kapur hapin e radhës, por edhe për të bërë

përparim real në terren dhe për ta ndryshuar realitetin", tha Varhelyi.

Hapet konkursi për 25 inspektorë shëndetësorë

PRISHTINË, 12 KORRIK - Të mërkurën është hapur konkursi për 25 inspektorë shëndetësorë. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se ashtu siç kanë premtuar, numri i

inspektorëve po rritet. “Vetëm 12 inspektorë shëndetësorë ishin në Republikën e Kosovës. Shumë shpejt numri i tyre do të rritet për 25 sosh. Pra,

po e bëjmë trefishimin e numrit të inspektorëve shëndetësorë, duke e ngritur atë në 37. Kjo padyshim do të ndikojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve

shëndetësore për qytetarët”, ka shkruar Kurti në “Facebook”, duke u bërë thirrje të gjithë atyre që janë të kualifikuar për këtë pozitë të konkurrojnë.



Haradinaj: Keqardhje për komunitetin serb që nuk e kishte kuptuar drejt ofertën time prej kryeministri

Prishtinë, 12 korrik - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se është për keqardhje që përfaqësuesit e komunitetit serb nuk e kishin kuptuar drejt ofertën e tij fisnike prej kryeministri për integrimin e tyre në institucionet e Kosovës. “Për fat të keq, ata nuk arritën ta kuptonin se krijimi i Ushtrisë së Kosovës, si parakusht edhe i anëtarësimit në NATO, do të ishte garanci më e mirë edhe për perspektivën e komunitetit serb, por e mohuan atë duke e bërë një vlerësim të gabuar dhe duke injoruar kështu proceset integruese”, ka shkruar Haradinaj

në “Facebook”.

Ai ka thënë se vendet anëtare të NATO-s e kanë shkallën më të lartë të respektimit të drejtave të njeriut pavarësisht prej etnisë apo çfarëdo përkatësie tjetër, gjë që do të ishte garanci edhe për komunitetin serb dhe të drejtat e tij. “Është në interesin e përbashkët që sot, pavarësisht se raportet janë më të acaruara, ta kuptojmë drejt njëri-tjetrin dhe ta gjejmë rrugën jo vetëm të shpërshkallëzimit të situatës, por edhe perspektivën e bashkëpunimit, si e vetmja rrugë e paqes, stabilitetit dhe prosperitetit për të gjithë”, ka thënë Haradinaj.



Dhurohen mjete mbrojtëse për gazetarët që raportojnë nga terrenet me rrezikshmëri



PRISHTINË, 12 KORRIK - Organizata Free Press Unlimited - FPU, me iniciativën dhe ndërmjetësimin e Zyrtarës Ligjore të European Centre for Press and Media Freedom ECPMF, Flutura Kusari, i

ka dhënë donacion AGK-së mjete mbrojtëse për gazetarët që raportojnë në terren ku rrezikohet siguria e tyre fizike.

Pjesa e parë e këtij donacioni që përmban 14 jelekë antiplumb, 16

helmata dhe 17 pako për ndihmë të parë është pranuar sot nga drejtoresha ekzekutive e AGK-së, Getoarë Mulliqi Bojaj, dhe zyrtarja ligjore e ECPMF-së, Flutura Kusari. Brenda muajit do të

arrijë edhe pjesa e dytë e këtyre mjeteve.

Shpërndarja e pajisjeve mbrojtëse për mediet do të bëhet duke marrë parasysh nivelet e rrezikut në vend. Gjithashtu, Asociacioni i

Gazetarëve i Kosovës, në koordinim me ECPMF-në dhe FPU, do ta bëjë shpërndarjen e jelekëve me mbishkrimin PRESS për mediet qendrore dhe lokale, të cilat raportojnë nga veriu i vendit.



Rama takon Macronin, i cili po përgatitet të vijë në Tiranë

Prishtinë, 12 korrik - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, po përgatitet të vijë në Shqipëri. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e ka dhënë këtë lajm në “Facebook”. Kreu i qeverisë ka shpërndarë

edhe një foto nga takimi që ka kryer me presidentin francez në Vilnius, aty ku ka marrë pjesë në samitin e NATO-s. “Vilnius, Lituani - Me presidentin e Francës, Emanuel Macron, i cili po përgatitet për të ardhur në

Tiranë”, ka shkruar Rama në “Facebook”.

Gjatë punimeve të samitit të NATO-s në Vilnius të Lituaniës, kryeministri Edi Rama ka zhvilluar një sërë takimesh me liderë dhe zyrtarë të lartë të shteteve anëtare të aleancës.





Kurti tërhiqet nga zotimet, pajtohet ta zvogëlojë praninë policore në veri, zgjedhjet pas verës

Qeveria e Kosovës ka pranuar ta shkurtojë praninë e policisë në dhe përreth ndërtesave komunale në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - komuna të banuara me shumicë serbe në veri, dhe se Kosova do ta mbështesë mbajtjen e zgjedhjeve të reja në katër komunat veriore për ta shtensionuar situatën. Pajtimi u arrit në një takim joformal në Bratislavë ndërmjet përfaqësuesit të posaçëm të BE-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak dhe zëvendëskryeministrit të Kosovës Besnik Bislimi. Qeveria e Kosovës ka njoftuar se të gjitha hapat do të finalizohen brenda një periudhë dyjavore

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 12 KORRIK - Qeveria e Kosovës është pajtuar ta zvogëlojë praninë policore në veri dhe ta mbështesë mbajtjen e zgjedhjeve të reja në katër komunat veriore si pjesë e veprimeve për ta shtensionuar situatën. Të gjitha hapat, sipas Qeverisë së Kosovës, do të "finalizohen brenda një periudhe dyjavore".

Ky pajtim u arrit gjatë një takimi joformal që u mbajt në Bratislavë midis zëvendëskryeministrit të Kosovës, Besnik Bislimi, dhe të dërguarit të posaçëm të BE-së

për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Sipas njoftimit të qeverisë, prania policore në dhe përreth ndërtesave komunale në veri do të zvogëlohet menjëherë për 25 për qind. Po ashtu, Kosova dhe BE-ja janë pajtuar edhe për ndërmarrjen e disa hapave të tjerë. "1. Qeveria e Kosovës publikisht e tregon gatishmërinë e saj për të kontribuar në deeskalimin e situatës dhe mosndërmarrjen e veprimeve që mund të eskalojnë situatën në veriun e vendit. Kjo përfshin një zvogëlim të menjëhershëm për 25% të prezencës policore në dhe rreth ndërtesave komunale. 2. Policia e Kosovës bashkë me

EULEX-in dhe KFOR-in, sipas nevojës do të vlerësojnë gjendjen e sigurisë, në veçanti për të shikuar mundësinë për zvogëlim të mëtejshëm të prezencës policore në dhe rreth ndërtesave komunale. 3. Qeveria e Kosovës përmes një deklarate publike mbështet mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme në katër komunat në veri të vendit dhe atë pas stinës së verës. Kosova shpreh përkushtimin për sigurimin e bazës së nevojshme ligjore për të mundësuar organizimin e këtyre zgjedhjeve. 4. BE-ja do ftojë dy kryenegociatorët në Bruksel me synim finalizimin e planit të sekuencimit për marrëveshjen

drejt normalizimit, pas të cilit do të fillojë zbatimi i të gjitha neneve të marrëveshjes", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Të mërkurën kryeministri Albin Kurti e ka njoftuar kabinetin qeveritar për takimin që ka pasur zëvendëskryeministri Besnik Bislimi në Bratislavë të Sllovakisë me përfaqësuesin e posaçëm të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor dhe dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak.

Ai ka thënë se synimi i takimit ishte që të krijohen parakushtet për fokus në zbatimin e plotë dhe pa kushte të Marrëveshjes Bazike.

Kurti ka thënë se zëvendëskryeministri Bislimi ka arritur një pajtim me emisarin e Bashkimit Evropian për këto katër pika të marrëveshjes. "Unë kam nënvizuar në vazhdimësi se për suksesin e zbatimit të marrëveshjes bazike: Së pari, të dy palët duhet ta pranojnë publikisht se marrëveshja është ligjrisht e obligueshme, gjë që nuk ka ndodhur ende nga pala serbe. Së dyti, që marrëveshja

duhet të zbatohet në plotni, gjë që me gjasë ende nuk është e qartë për njërin nga palët. Së treti, që zbatimi i neneve të marrëveshjes nuk mund të kushtëzohet. Dhe së katërti, që, të dyja palët duhet të kenë mundësinë të negociojnë nga pozicione të barabarta, gjë që është cenuar prej vendosjes së masave të përkohshme kundër Kosovës nga ana e Bashkimit Evropian. Si përfundim besoj që dakordimi i Bratislavës do të ndihmojë shumë në përforcimin e fokusit dhe vendosjen e barazisë midis palëve, që ndihmon zbatimin e plotë të Marrëveshjes Bazike dhe të Aneksit të saj", ka thënë Kurti. Bashkimi Evropian kishte paraqitur disa kërkesa për uljen e tensioneve në veri, që nisën në fund të majit, pasi kryetarët e rinj shqiptarë të Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut hynë në ndërtesat komunale nën përcjelljen e Policisë së Kosovës. Që atëherë serbët lokalë po protestojnë në veri, duke kërkuar që, përveç kryetarëve, të tërhiqen edhe njësitë speciale policore

Aktakuzë ndaj një serbi për krime të luftës kundër popullatës civile

PRISHTINË, 12 KORRIK - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Special - kundër të pandehurit me inicialet S. T., i nacionalitetit serb. Prokuroria Speciale njofton se aktakuza kundër të pandehurit të lartcekur është ngritur për shkak të dyshimit se gjatë kohës së luftës në Kosovë, në periudhën kohore 1998-1999, në fshatin Reznik, komuna e Vushtrrisë, dhe në fshatrat përreth të rajonit të Vushtrrisë, individualisht dhe në bashkëkryerje me persona të tjerë, duke shkelur rëndë rregullat e të drejtës ndërkombëtare si pjesëmarrës i

forcave policore dhe ushtarake serbe, ka kontribuar në vrasje, bastisje, rrahje, maltretim, arrestim, torturë, trajtim në mënyrë mizore dhe çnjerëzore, mbajtje në kushte skllavërie, dëbimi dhe depërtimi i mijëra civilëve shqiptarë si dhe masat e plaçkitjes, djegies dhe shkatërrimit të shtëpive të popullsisë civile të nacionalitetit shqiptar që nuk kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në konflikt, me ç'rast ka shkelur rëndë rregullat e të drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës, konkretisht nenin 3, paragrafin 1, shkronjat a, b, c, të përbashkët me katër konventa (1a dhe b) të përbashkëta për katër Konventat e Gjenevës të

datës 12 gusht të vitit 1949 dhe Protokollet shtesë (protokollin I). Me këto veprime i pandehuri S. T., në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të panjohur të njesisë së përmendur të policisë serbe dhe persona të tjerë të armatosur dhe të uniformuar, ka kryer veprën penale "Krimet e luftës kundër popullatës civile", e paraparë dhe e dënueshme sipas nenit 142 dhe 22 të Ligjit Penal të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht i inkriminuar si krime kundër njerëzimit nga neni 143, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, 1.6 dhe 1.7 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.



Kryetari i PDK-së, vizitë zyrtare në Paris dhe Bruksel



Prishtinë, 12 korrik - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, të enjten dhe të premten do të qëndrojë në Paris

dhe Bruksel. Ai në dy kryeqendrat evropiane do të takojë shumë miq, aleatë dhe zyrtarë të lartë evropianë për të

diskutuar në lidhje me situatën aktuale në Kosovë. "Rrugëtimi i Kosovës, historikisht, nuk do të ishte kaq i suksesshëm pa

mbështetjen dhe koordinimin me aleatët tanë. Prandaj, angazhimi i kryetarit Krasniqi për t'i ruajtur dhe kultivuar këto

raporte, në shërbim të së ardhmes së sigurt të vendit tonë, është i përditshëm dhe i pandalshëm", ka njoftuar PDK-ja.

nga veriu.

Edhe më herët krerët shtetërorë në Kosovë janë shprehur të gatshëm të organizojnë zgjedhje të reja në komunat në veri, por kanë kërkuar që ato të përgatiten në mënyrë që të mos ketë bojkotim.

Zgjedhjet e 23 prillit, nga të cilat dolën kryetarët e rinj shqiptarë në katër komunat në veri, ishin bojkotuar nga partitë dhe popullata serb.

Ndryshe, Kosova ka kërkuar vazhdimisht që të nisë zbatimin e Marrëveshjes drejt Normalizimit të raporteve, që u arrit në Bruksel më 27 shkurt. Palët më 18 mars në Ohër arritën edhe Aneksin për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Marrëveshja, prej 11 nënesh, nuk

përfshin njohjen reciproke për të cilën insiston Kosova, por kërkon nga Kosova dhe Serbia t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë: pasaportat, diplomat dhe targat.

Dokumenti kërkon nga palët t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tash në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë edhe atë për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, të cilin qeveria në Prishtinë e ka refuzuar deri më tash, me arsyetimin se mund ta rrezikojë funksionalitetin e shtetit.

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Jeffrey

Hovenier, ka thënë se e ka të vështirë të përgjigjet nëse është afër të arrihet shtensionimi i situatës në veri. Këtë deklaratë Hovenieri e bëri në ditën pasi zyrtarë nga Kosova dhe Bashkimi Evropian thanë se kanë arritur pajtim për hapat e parë drejt uljes së tensioneve. "Çfarë mund të them nga perspektiva e ShBA-së është se kjo është shumë e rëndësishme dhe mund të përsëris atë që e kemi thënë shpesh, e që shpresojmë të shohim një shtensionim të plotë në veri. Ne duam t'i kthehemi punës që vërtet është e rëndësishme, në mënyrë që ta shohim zbatimin e plotë nga të dyja palët të Marrëveshjes së Ohrit. Kjo nënkupton



Kuvendi Komunal i Rahovecit shkarkon kryesuesin Defrim Kafexhiu

RAHOVEC, 12 KORRIK - Kuvendi Komunal i Rahovecit, në një seancë të jashtëzakonshme, nga 27 kuvendarë të pranishëm, me 16 vota "për", 10 "kundër" dhe 1 votë

"abstenim", e ka shkarkuar kryesuesin e deritanishëm, Defrim Kafexhiu. Në rend dite ishte vetëm një pikë: Votëbesimi i kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Prej fillimit deri në fund seanca u karakterizua e qetë dhe pa ndonjë tentativë që mund ta pengojë procesin e votimit dhe fjalës së kuvendarëve. Kërkesën për shkarkimin e

kryesuesit, në emër të 16 kuvendarëve, të cilët e kanë iniciuar këtë mbledhje të jashtëzakonshme, e ka arsyetuar Hasan Përboqi, shef i grupit të AAK-së në Kuvendin Komunal.



Policia në Shtime nis fushatën 'Mos parko'



Shtime, 12 korrik - Policia e Stacionit në Shtime, në bashkëpunim me komunën e Shtimes, ka realizuar një fushatë sensibilizuese për parkingjet e parregullta. Qëllimi i kësaj fushate ishte sensibilizimi i drejtuesve të automjeteve, pjesëmarrës në komunikacion, për parandalimin e kundërvajtjeve në komunikacion, parkingjet e parregullta, bllokimin e trotuareve, bllokimin e shtigjeve të biçikletave, hapësirave të tjera publike dhe kujdesit ndaj këmbësorëve. Policia me këtë rast shpërndau edhe disa fletëpalosje me disa porosi për shoferët. "Ishte kjo edhe një përpjekje e policisë që

t'i ndërgjegjësojë të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, me theks të veçantë që drejtuesit e automjeteve mos të parkojnë automjetet e tyre në mënyrë të parregullt dhe ta shtojnë kujdesin ndaj këmbësorëve. Pas kësaj fushate, veç vërejtjeve policore, policia e Stacionit në Shtime për të gjithë drejtuesit e automjeteve të cilët parkojnë automjetet e tyre në kundërshtim me rregullat dhe ligjet e komunikacionit, do të vendosë në xhamin e secilit automjet njoftimin për paraqitje të obligueshme në Stacionin e Policisë dhe shoferit do t'i shqiptohet gjoba", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Nis fushata e korrje-shirjeve në Lipjan

Lipjan, 12 korrik - Ka filluar fushata e korrje-shirjeve në komunën e Lipjanit për vitin 2023. Këtë fushatë nga afër e ka përcjellë edhe drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në komunën e Lipjanit, Rexhep Rexhepi. "Fermëtarët lipjanas i përgëzoj për punën dhe përkushtimin e tyre, duke uruar të kemi rendimente të larta të prodhimit dhe të korra të bërëqetshme", është shprehur drejtori Rexhepi.

Ai ka theksuar se aktualisht në komunën e Lipjanit, sipas shënimeve që ka Drejtoria e Bujqësisë, janë mbjell 5 500 hektarë grurë, në terren janë duke operuar mbi 120 autokombajna dhe rendimentet për këtë vit sillen rreth 4 000 deri 4 500 kg grurë për hektar. Sipas rekomandimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, çmimi i korrje-shirjes për një hektar në këtë vit është 130 euro.



Fillon ndërtimi i kanaleve në fshatrat Hoçë e qytetit, Kobaj dhe Grazhdanik të Prizrenit

PRIZREN, 12 KORRIK - Temperaturat e larta që mund të mbretërojnë gjatë këtij viti nuk do të shkaktojnë probleme për shumë zona bujqësore pasi po investohet në sigurimin e ujit për vaditjen e tokave dhe

menaxhimin afatgjatë të sistemeve të ujitjes në komunën e Prizrenit. Komuna ka njoftuar se ka filluar ndërtimi i kanaleve në fshatrat Hoçë e qytetit, Kobaj dhe Grazhdanik, të cilat pritet të përfundojnë sipas

dinamikës së paraparë. Gjithashtu, ka njoftuar se po rregullohet infrastruktura e ujitjes së tokave bujqësore në kuadër të projektit të DBZHR-së "Rehabilitimi i kanaleve ujitëse dhe kullimi i tokave bujqësore".

Nis asfaltimi i rrethrotullimit në rrugën "Ramadan Rexhepi" në Ferizaj

FERIZAJ, 12 KORRIK - Komuna e Ferizajt ka nisur asfaltimin e rrethrotullimit në rrugën "Ramadan Rexhepi". Kryetari i kësaj komune,

Agim Aliu, ka bërë me dije se ky investim u paraprinë punimeve në projektin për ndërtimin e nënkalimit te Stacioni Policor. "Ky investim me

infrastrukturën përcjellëse rigjeneron gjithë zonën por që, njëkohësisht, është pjesë dhe u paraprinë punimeve në shtrirje masive në projektin për

ndërtimin e nënkalimit për vetura dhe këmbësorë te Stacioni Policor, vepër kjo që i jep dimension të ri zhvillimit të Ferizajt", ka njoftuar Aliu.



Ngujimi 43-ditor i kryetarit të Leposaviqit: Familja s'e di sa mund të zgjasë

LEPOSAVIQ, 12 KORRIK - Kryetari i ri shqiptar i Leposaviqit, komunë e banuar me shumicë serbe në veriun e Kosovës, po qëndron i mbyllur në ndërtesën komunale prej kur hyri aty, mbi dyzet ditë më parë.

Lulzim Hetemi u ndihmua nga Njësia Speciale e Policisë së Kosovës që të futej në zyrën e tij në mëngjesin e hershëm të 29 majit, dhe që nga ajo ditë nuk është raportuar të ketë dalë nga objekti komunal. Aty Lulzim Hetemi ha, rri, punon, pastrohet dhe fle.

Hyrja e tij në objektin komunal u prit me protesta nga banorë vendës serbë dhe nga grupe të ndryshme të dhunshme, që sulmuar forcat e rendit dhe gazetarët e mbledhur.

Vëllai i kryetarit të Leposaviqit pohon se familjari i tij po punon në kushte të jashtëzakonshme brenda ndërtesës komunale, por thotë se nuk mund t'i komentojë arsyet se "si dhe pse ai [Lulzim Hetemi] po rri ende brenda komunës". "Normalisht, puna e kryetarit është shumë sfiduese. Besoj, dhe shpresoj që ia del, por këto rrethana, normalisht, janë shumë të rënda për të dhe për ne. Është problem të punohet në këto kushte, por besoj se ai do t'ia dalë. Pse, si po qëndron, nuk mund të flas në emër të tij", deklaroi Bashkim Hetemi për Radion Evropa e Lirë.

Ai thotë se e gjithë familja Hetemi është e shqetësuar për mungesën e funksionimit të rendit dhe të ligjit në pjesën veriore të Kosovës. Sipas Bashkim Hetemit, "diçka nuk është në rregull" as me qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare, e cila, ndonëse deklaroi njohjen e rezultatit të zgjedhjeve të jashtëzakonshme në katër komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe, po kërkon largimin e kryetarëve, përfshirë vëllanë e tij nga ndërtesat komunale.

Bashkim Hetemi thotë se komunikon shpesh me Lulzim Hetemin, porse nuk e ka të qartë edhe sa do të jetë në gjendje vëllai i tij ta ushtrojë funksionin e kryetarit në kushtet e tanishme. "Nuk e di sa gjatë mund të shkojë në këto rrethana, por rrethanat në të cilat po punon ai [Lulzim Hetemi] janë të jashtëzakonshme. Shumë e ka të vështirë punën. Atë nuk po e lejojnë të punojë normalisht", shprehet Bashkim Hetemi.

Radio Evropa e Lirë e ka kontaktuar disa herë kryetarin e Leposaviqit, që nga mbyllja e tij në vendin e punës, por ai nuk është përgjigjur.

Lulzim Hetemi është kontaktuar edhe për këtë artikull, por ai nuk u është përgjigjur as thirrjeve, as porosive me shkrim në telefon.

Partia s'e komenton ngujimin e Hetemit

Se pse Hetemi po vazhdon të mos largohet nga ndërtesa e komunës nuk ka folur as partia që ai i përket, Lëvizja Vetëvendosje (LV). Subjekti politik, që udhëheq edhe



Kosovën në nivelin qendror, nuk ka komentuar as kur është pyetur se edhe sa kohë do të vazhdojë Hetemi të qëndrojë i ngujuar. Por, se Hetemi e kishte seriozisht qëndrimin në ndërtesën komunale në Leposaviq, bëri me dije kryeministri i Kosovës, njëherësh kryetar i LV-së, Albin Kurti. Kur po përshkruante një telefonatë me Hetemin, Kurti tha më 11 qershor se "tekta unë isha i brengosur se mos është mërzhitur [Hetemi], ai ishte brengosur se mos jam mërzhitur unë".

Hetemi është vizituar në ndërtesën komunale në Leposaviq nga zyrtarë të ndryshëm të Qeverisë së Kosovës - përfshirë ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi; ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla; ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu - si dhe nga deputetë të LV-së. Protestat kundër kryetarit të ri shqiptar janë duke vazhduar në Leposaviq.

Pas rritjes së tensioneve në komunat në veriun e Kosovës, të banuara me shumicë serbe, komuniteti ndërkombëtar, duke përfshirë Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kërkoi që kryetarët e rinj të largoheshin nga objektet komunale dhe t'i ushtronin funksionet e tyre nga ndërtesa alternative.

Kështu vepruan kryetari i Zubin Potokut, Izmir Zeqiri, dhe ai i Zveçanit, Ilir Peci, që të dy nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Përveç Hetemit, që mbetet i ngujuar në objektin e komunës në Leposaviq, largimin nga objekti komunal raportohet se kohë pas kohe e bën edhe kryetari i Mitrovicës së Veriut.

Erden Atiq nuk ka folur për këto pohime, ndonëse është parë në disa raste jashtë ndërtesës së komunës, përfshirë në një aktivitet në Ambasadën Amerikane në Prishtinë për shënimin e 4 Korrikut - Ditës së Pavarësisë së ShBA-së. Atiq nuk i është përgjigjur interesimit të Radios Evropa e Lirë rreth këtyre pohimeve. I kontaktuar disa herë nga REL-i, Atiq nuk ka kthyer përgjigje. Megjithatë, pohimet se, në periudha të ndryshme, Atiq ka qëndruar edhe natën në objektin e komunës, i mohon nënkryetarja e Mitrovicës së Veriut, Katarina Agjançiq.

"Atiq qëndron në ndërtesën e komunës jashtë orarit të punës. Ai është këtu nga ora 8 deri në orën 4, ose ndoshta më vonë, por sigurisht që shkon në shtëpi. Ai jeton në Mitrovicë [të Jugut]", shprehet Agjançiq për Radion Evropa e Lirë.

Ajo shton se konsultohet me Atiqin për të gjitha vendimet, dhe se bashkëpunimi mes tyre është i mirë, por thekson se duhet edhe

pak kohë që komuna e Mitrovicës së Veriut të punojë me kapacitet të plotë. "Ne ende po organizohemi, po emërojmë drejtorë departamentesh, ka shumë sektorë të pambuluar, por po zgjidhim [punët] gradualisht. Kur t'i kemi emëruar të gjithë drejtorët, do ta shpallim edhe konkursin për përzgjedhjen e zyrtarëve. Mezi pres të fillojnë investimet kapitale, që qytetarët ta ndiejnë përmirësimin", thotë ajo.

Markoviqi: Kryetarët nuk zgjidhin dot asnjë problem esencial

Drejtori i programeve në organizatën "Aktiv", me bazë në Mitrovicën e Veriut, Igor Markoviqi, thotë se kryetarët e rinj nuk mund të zgjidhin asnjë problem esencial për jetën e qytetarëve. "Përderisa të dyja komunat [Leposaviq dhe Zubin Potoku] vuajnë nga shumë probleme që duhet të zgjidhen shpejt, kryetarët e porsazgjedhur nuk po merren me këto çështje kyçe, duke e rezikuar kështu edhe më shumë procesin e integritetit të veriut të Kosovës, që zbatohet që nga viti 2013", shprehet Markoviqi për Radion Evropa e Lirë. Ai vlerëson se kryetarët po bëjnë edhe gabime, duke iu referuar vendimit të komunës së Mitrovicës së Veriut



për hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër, mes saj dhe Mitrovicës së Jugut, në një kohë kur, siç thotë ai, tensionet kishin kulmuar.

Markoviqi pohon se kryetari i Mitrovicës së Veriut ka pasur dhe tema më me prioritet, me të cilat do të duhej të merrej, përfshirë çështjen e qenve endacakë, mungesën e hapësirave të gjelbra publike, problemet me ujësjellësin, si dhe parkimin e paligjshëm.

Ndërkaq, për kryetarin e Leposaviqit, Markoviqi, thotë se, përveç se ka përfunduar në ballinat e medieve lidhur me ngujimin e tij në ndërtesën e komunës, nuk ka bërë asnjë gjë që parashihet në përshkrimin e detyrave të tij të punës. "Për më tepër, refuzimi i tij për t'u larguar nga ndërtesa ka tërbuar edhe më shumë komunitetin lokal, aq sa ai ka humbur edhe legjitimitetin më të vogël në sytë e komunitetit, i cili mund të ishte ndërtuar gradualisht, përmes zbatimit të të ashtuquajturit rol të kryetarit teknik, në ndonjë objekt tjetër, siç ishte rasti në dy komunat e tjera veriore të Kosovës", shprehet Markoviqi për REL-in.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme në katër komuna veriore të Kosovës, të banuara me shumicë serbe - Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq - u mbajtën më 23 prill të këtij viti, pas dorëheqjes së kryetarëve nga radhët e Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve të Kosovës - në nëntorin e 2022-s. Ato u bojkotuan nga popullata shumicë serbe në atë zonë, që tani nuk i pranon kryetarët e rinj shqiptarë, ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës njoftoi se në procesin e votimit morën pjesë vetëm rreth 3 për qind të personave me të drejtë vote.

Zubin Potokut dhe Zveçanin i fituan kandidatët e Partisë Demokratike të Kosovës, ndërsa Mitrovicën e Veriut dhe Leposaviqin i mori Lëvizja Vetëvendosje.

Që nga marrja e detyrës, aktiviteti i kryetarëve të rinj është shumë i kufizuar, ndërsa legjitimiteti po u kontestohet.

Largimi i Hetemit dhe i Atiqit nga zyra është një prej kërkesave që komuniteti ndërkombëtar i ka paraqitur Qeverisë së Kosovës në planin që ka paraqitur për shtensionimin e situatës në veriun e Kosovës.

Në këtë pjesë të Kosovës protestat e banorëve serbë kundër kryetarëve të rinj shqiptarë u përshkallëzuan edhe në përlëshje të dhunshme, me dhjetëra të plagosur - në mesin e të cilëve edhe ushtarë të misionit të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë, KFOR.


Qeveria e Kosovës njoftoi më 11 korrik se është pajtuar që ta zvogëlojë praninë policore në veri dhe ta mbështesë mbajtjen e zgjedhjeve të reja në katër komunat veriore si pjesë e veprimeve për ta shtensionuar situatën.

Inspektorati i Tregut del në terren, inspekton pikat e shitjes së karburanteve

PRISHTINË, 12 KORRIK - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka njoftuar të mërkurën se Inspektorati i Tregut po bën kontrolle të pikave shitëse të karburanteve të naftës për të vërtetuar se qytetarët nuk po mashtrohen në sasinë e karburanteve që paguajnë. Inspektorët kanë vazhduar verifikimin e sasisë nëpër

pikat e shitjes së derivateve të naftës me qëllim të parandalimit të çfarëdo mashtrimi që mund të bëhet me sasinë e deklaruar. “Përmes etalonëve të kalibruar, nga inxhinierët e metrologjisë, bëhen matjet e duhura me anë të të cilave vërtetohet nëse litri i deklaruar ka sasinë e saktë. Në rastet kur ka devijime, Inspektorati i Tregut ndërmerr masat e

duhura ndëshkuese ndaj subjekteve që kanë mashtruar konsumatorët”, thuhet në komunikatën për medie të MINT-it. Inspektorati i Tregut thuhet se do të vijojë ta mbikëqyrë tregun me intensitet të shtuar dhe ta trajtojë secilën nga ankesat e konsumatorëve, për çfarë edhe i inkurajon ata t'i paraqesin parregullsitë që hasin.



Qeveria miraton Projektligjin për projektin “Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10”



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 KORRIK - Qeveria e Kosovës ka zhvilluar të mërkurën mbledhjen e rregullt në të cilën ka miratuar disa projektligje. Kabineti qeveritar ka miratuar Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit në

mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Punës, Financave dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin “Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10 - B”. Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të mundësojë renovimin e Linjës Hekurudhore 10 B, e cila

shkon nga Hani i Elezit deri në Leshak.

Kjo linjë do të jetë me standardet e Bashkimit Evropian, duke lejuar operimin deri në 100 km/orë në shumicën e seksioneve të linjës hekurudhore. Realizimi i këtij projekti vlerësohet të jetë 250 000 000.00 euro (dyqind e pesëdhjetë milionë euro).

Qeveria ka miratuar edhe Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027, që do të synojë modernizimin dhe përshtatjen e bujqësisë në vendin tonë në përputhje edhe me zhvillimin e gjithëmbarshtëm dhe me zhvillimin e tregut të ne. Gjithashtu, është miratuar edhe Projektligji për

Ndryshime Klimatike. “Për herë të parë, si qeveri, po sjellim Projektligjin për Ndryshime Klimatike, që për qëllim ka bazën rregullative dhe shkencore për plane e investime konkrete në përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjen e emetimeve të gazrave serë”, ka thënë kryeministri Albin Kurti.

Auditorët e ZKA-së trajnohen për auditime hulamtuese

PRISHTINË, 12 KORRIK - Auditorët nga Zyra Kombëtare e Auditimit, Ajtene Llapashtica, auditore financiare dhe Labinot Sadiku, auditor senior i performancës, ndoqën Shkollën Verore të EUROSAT-it për auditime hulamtuese nga 2 - 6 korrik 2023 në Hagë të Holandës.

Në kuadër të programit auditorët tanë me kolegë nga Britania e Madhe, Franca, Lituania, Shqipëria, Belgjika, Italia etj. patën rastin të mësojnë më shumë për metodologjinë, studimin e rasteve, pyetjet hulamtuese dhe prezantimin e rezultateve të auditimit hulamtues.

Më tutje u paraqitën edhe metodat e auditimit, rastet e studimit dhe procedurat e tjera të cilat ndërlidhen me procesin e auditimit.

Trajnimi u mbajt nga përfaqësues të Institucioneve Supreme të Holandës dhe të Britanisë së Madhe dhe kishte qëllim ndarjen e përvojave të vendeve të ndryshme për auditimet hulamtuese.

Temat e auditimeve hulamtuese, realizuar nga Institucioni Suprem i Auditimit të Britanisë së Madhe, ishin për “Auditimin e Covid 2019”, ndërsa ato nga Institucioni Suprem i Auditimit të Holandës ishin

“Gripi i Shpendëve në Holandë”, “Siguria e Objekteve të Ushtrisë” etj.

Auditimet hulamtuese kishin filluar të realizoheshin kryesisht nga viti 2019 dhe varësisht nga nevoja, ndërsa periudha e realizimit të tyre ishte 12-13 javë.

Qëllimi i këtyre auditimeve është kryesisht prezantimi i gjendjes në fusha të ndryshme përmes analizimit të të dhënave dhe vlerësimit të funksioneve të sistemeve dhe proceseve. Këto auditime nuk kanë për qëllim dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve, megjithatë nuk kanë kufizime në këtë aspekt.



Si i fitojnë paratë gjenitë? Ja çfarë në mëson historia



Nga Jonny TOMSON

Me fat janë ata njerëz që paguhen për të bërë atë që duan. Siç e thotë edhe shprehja “Nëse gjen një punë që e do, nuk do të duhet të punosh asnjë ditë në jetën tënde!”. Por pak njerëz mund të mbijetojnë vetëm nga një punë që e dashurojnë vërtet. Artistët, shkrimtarët, muzikantët, kërcimtarët, aktorët ose koleksionistët anembanë botës dëshirojnë të fitojnë mjaftueshëm nga pasionet e tyre, që të mund ta mbajnë frymën gjallë.

Mjerisht, jeta e ka zakon të kërkojë nga ne atë që nuk duam ta japim. Pra, shumica prej nesh përfundojmë duke punuar në mënyrë që të mund të aktojme. E njëjta gjë vlente dikur për shumë prej artistëve, shkencëtarëve, novatorëve dhe mendimtarëve më të mëdhenj. Gjenitë e historisë duhej të paguanin faturat dhe të ushqenin familjen, po aq sa ne të tjerët. Sigurisht, shumë nga “njerëzit më të mëdhenj” të të gjitha kohërave patën shumë ndihmë. Ata ishin lordë ose baronesha, trashëgimtarë të pasurive, ose me titujt aristokrat. Por të tjerët kishin një prejardhje shumë më modeste. Ja 4 shembuj se si e fituan jetesën disa nga emrat më të mëdhenj në histori:

Isak Njuton

Njutoni ka qenë një nga njerëzit më të ditur dhe më inteligjentë në histori. Por familja e tij ishte

fshatare, dhe babai i tij ishte një burrë i pashkolluar që nuk mund të shkruante dot as emrin e tij. Kur shkoi në Universitetin e Kembrixhit, ai duhej ta fitonte shkollimin e tij duke qenë shërbëtor i studentëve të tjerë.

Kur një epidemi murtaje i ktheu të gjithë studentët në shtëpi, Njutoni e kaloi kohën duke revolucionarizuar matematikën, optikën, fizikën dhe astronominë. Kur u rikthye në universitet iu dhanë poste të larta akademike. Por në atë kohë këto tituj nuk të dhuronin miliona. Pas vitesh punë të palodhur, presionesh nga mbreti katolik Xhejmsi II (pasi Njutoni ishte protestant) dhe një krize nervore, Njutoni vendosi të hiqte dorë nga të gjitha për t’u bërë i pasur.

Në Londër, ai përdori gjenialitetin e tij në matematikë për t’u bërë krye-bankier i mbretit. Me kursin e sotëm, ai ka të ngjarë të ketë pasur një pagë me 7 shifra. Pra, pavarësisht se shkroi atë që njihet si një nga veprat më të mëdha shkencore të të gjitha kohërave, Njutoni i fitoi paratë e tij kryesisht nga të qenit një bankier i qeverisë mbretërore.

Uilliam Shekspiri

Jeta e një aktori është e vështirë. Ajo nënkupton orë të gjata pune, dhe ndonjëherë duhet të angazhohesh në 2 ose 3 shfaqje brenda ditësh. Aktorët e sotëm raportojnë nivele dukshëm më të larta të depresionit, ankthit dhe stresit sesa popullsia mesatare. Por gjërat ishin paksa më ndryshe në Anglinë e shekullit XVII-të.

Edhe pse njihet gjerësisht si shkrimtari, poeti, dramaturgu më i madh në histori, Shekspiri nuk pati një jetë luksoze me pallate, verëra dhe kuaj të mirë. Babai i Shekspirit, duke kursyer pak nga shitja e leshit në tregun e zi, i dha të riut Uilliam paratë për të blerë aksionet në kompaninë e tij të parë teatrale.

Kompania fitoi mirë, por asnjëherë aq shumë sa për ta bërë të pasur. Shekspiri nuk u pagua asnjëherë si autor i dramave, por nga fitimet e gjithë trupës së aktrimit. Nëse aktorët do të ishin të dobët, apo nëse shfaqja nuk do të vlerësohej, Shekspiri do të ishte në telashe.

Për Shekspirin ka shumë pak të dhëna. Por 2 dokumente tregojnë se ai pati 2 herë probleme me mospagimin e taksave. Nuk mund të jemi të sigurt nëse kjo ishte nga dyfytërsia, neglizhenca apo mungesa e parave. Por dimë se në prag të vdekjes, Shekspiri jetonte në një shtëpi të mirë, por jo shumë të madhe. Ai i shiti aksionet e tij në kompaninë teatrore, për të pasur sa më shumë të ardhura të disponueshme.

Mari Kyri

Fituese e Çmimit Nobel në dy fusha të ndryshme, Marie Curie ishte një nga 5 fëmijët e familjes, të cilën i ati e zhyti në mjerim pas një sërë investimesh të tmerrshme. Në moshën 17-vjeçare, Mari bënte 3 punë si mësuese, si lexuese për punëtorët dhe si guvernante, në mënyrë që të mund të financonte jo vetëm

arsimin e saj, por edhe të motrës. Kur shkoi në Universitetin e Sorbonës, në Paris, punonte aq shumë gjatë natës sa shpesh harronte të hante. Aty asaj iu dhanë grante të ndryshme kërkimore për të studiuar çelikut. Kur bashkëshorti i saj vdiq pasi u godit nga një karrocë, ajo mori përsipër punën e tij, dhe kështu u bë profesoresha e parë grua në Sorbonë.

Por pas fitimit të Çmimeve Nobel për fizikë dhe kimi, paratë nuk ishin më një problem për të. Me kursin e sotëm, çmimi i saj i vitit 1903 vlen afërsisht 550.000 dollarë. Dhe ajo fitoi 2 të tillë. Por në vend se t’i shpenzonte për një jetë mondane, Kyri i shpenzoi për krijimin e institucioneve kërkimore. Albert Ajnshtajni mendohet të ketë thënë: “Nga të gjithë njerëzit e famshëm, Kyri është e vetmja që nuk u korruptua nga fama!”

Rene Dekarti

Nëna e Dekartit vdiq kur ai ishte vetëm 1-vjeç. Babai i filozofit, një politikan i njohur i zonës, ishte shumë i zënë dhe shumë i varfër për t’u kujdesur për Renenë dhe vëllezërit e motrat e tij. Pasi u dërgua për të marrë një arsimim të mirë (por edhe të rreptë) tek Jezuitët, Dekarti lulëzoi si një nga gjenitë e Rilindjes.

Por netët e gjata, leximi nën dritën e qiririt, dhe zhbërja e modelit shkencor aristotelian, bërë që Dekarti të braktiste jetën universitare pas një krize nervore. Gjithsesi me intelektin e jashtëzakonshëm vijnë shumë

mundësi. Ai fitoi disa para duke përdorur teorinë e probabilitetit, përpara se t’i bashkohej ushtrisë. Atje projektoi të gjitha llojet e fortifikimeve mbrojtëse, mjetet e rrethimit dhe armët vdekjeprurëse për të ndihmuar punëdhënësin e tij, Princin Moris të Nasaut. Por me gjithë gjenialitetin e tij në shumë fusha, Dekarti e përfundoi jetën e tij në arrati dhe në mëshirën e cilitdo që do ta pranonte ta punësonte.

Punë me gjysmë kapaciteti

E vërteta e trishtueshme e gjenit, është se ai nuk paguan faturat. Pas çdo mendimtari, zbulimi, shpikjeje apo kryevepre arti, fshihen ose orë shumë të gjata pune të lodhshme ose një trashëgimi dhe pasuri e madhe. Fakt është se gjenit i duhet kohë dhe para për t’u rritur.

Është dëshpëruese të mendosh se sa artistë, shkencëtarë, shkrimtarë apo filozofë kemi humbur, thjesht sepse ishin shumë të zënë me punë për të ushqyer fëmijët e tyre. Sa shpesh është shpërdoruar gjenialiteti duke larë enët apo duke rregulluar shtratin?

Kjo vlen sidomos për gratë. Filozofja angleze Meri Uollstounkraft, tha dikur se nëse shoqëria i detyron gratë të jenë qytetare të klasit të dytë – të mbyllura, të paarsimuar dhe të papunësuar – atëherë përparimi do të ecë vetëm me gjysmën e kapacitetit (vetë ajo ishte me fat pasi vinte nga një familje shumë e pasur).

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Pesë klube gjermane e duan Rashicën

STAMBOLL, 12 KORRIK - Galatasaray ende nuk po arrin marrëveshje me Norwich Cityn lidhur me transferimin e Milot Rashicës në Turqi. Ylli i

Kosovës duhet të rikthehet në Angli për t'i nisur përgatitjet për sezonin e ri, derisa mediet në ishull raportojnë se 27-vjeçarin e duan pesë klube nga

Bundesliga. Ndërsa interesim për Rashicën ka shfaqur edhe Beshiktashi. Besohet se Rashica dëshiron që edhe në sezonin e ri të jetë pjesë e

Galatasaryt, me të cilën arriti të shpallet kampion në Turqi dhe kontribuoi me 11 gola gjatë 26 ndeshjeve sa i zhvilloi në sezonin 2022/23.



Sonte luajnë në Ligën e Konferencës, Gjilani dhe Dukagjini



"Epoka e re"

PRISHTINË, 12 KORRIK - Kampioni në fuqi i Kosovës në futboll, Ballkani, e ka dhënë provimin në garat evropiane, përkatësisht në Ligën e Kampionëve, pasi e ka mposhtur skuadrën e Ludogorensit me rezultat 2-0 në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri", duke bërë një hap të madh drejt kalimit historik të rrethit të parë të garës

elitare të futbollit evropian.

Sonte (e enjte) në Ligën e Konferencës do të paraqiten Gjilani dhe Dukagjini. Skuadra e Gjilanit, që i përfundoi e treta garat në Superligën e Kosovës, do të përballet nga ora 19:30 me skuadrën e Luksemburgut, FC Progres Niederkorn. Synim i gjilanasve është të nxjerrin rezultat të favorshëm në mënyrë që ndeshjen e kthimit ta kenë më të lehtë. Ndërsa skuadra e Dukagjinit nga

Klina është përgatitur maksimalisht për ndeshjen e rrethit të parë të Ligës së Konferencës. Përballë do ta këtë Europa FC të Gjibraltarit. Ndeshja mes këtyre dy skuadrave do të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" me fillim nga ora 19:00. Skuadra e tretë që përfaqëson Kosovën në garat evropiane, Drita, do të ketë përballje të vështirë ndaj FC Viktoria Plzenit nga Çekia. Ndeshja e parë do të zhvillohet më 27 korrik, e kthimit më 3 gusht.

Klubet e hendbollit më 18 korrik mësojnë kundërshtarët në Kupën Evropiane

PRISHTINË, 12 KORRIK - Kampionia e elitës së hendbollit, Besa Famgas dhe fituesja e Kupës së Kosovës, Trepça, do të garojnë në Kupën Evropiane për hendbollistë në edicionin e ardhshëm garues 2023/2024. Në EHF European Cup gjithsej do të paraqiten 76 skuadra evropiane. Besa Famgas e Trepça garimin e fillojnë prej raundit të dytë. Ndeshjet e raundit të dytë zhvillohen më 14/15 tetor dhe

21/22 tetor. Shorti tërhiqet më 18 korrik në Vjenë. Raundi i parë i Kupës Evropiane luhet në shtator, ndërsa paraqiten 24 skuadra. Në short Besa Famgas është bartëse, ndërsa Trepça nuk është bartëse. Në raundin e dytë të Kupës Evropiane ka skuadra të forta nga shumë vende evropiane. KHF Istogu dhe KHF Ferizaj do të garojnë në Kupën Evropiane (EHF European Cup) për hendbollistë

në edicionin 2023/2024. Istogu e Ferizaj janë në mesin e 64 skuadrave të Kupës Evropiane. Të gjitha do ta fillojnë garimin prej raundit të dytë. Ndeshjet e para janë më 23 e 24 shtator, ndërsa të kthimit më 30 shtator e 1 tetor. Shorti për raundin e dytë do të tërhiqet më 18 korrik në Vjenë. Në short kampioni Istogu do të jetë bartës, ndërsa Ferizaj do të jetë në mesin e skuadrave jobartëse.



Ademi pret në takim klubet e promovuara në një rang më të lartë të garave

PRISHTINË, 12 KORRIK - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi ka pritur të mërkurën drejtuesit e klubeve të cilat janë promovuar në një rang më të lartë të garave për edicionin e ri. Klubet e promovuara janë FC Feronikeli 74, KF Fushë Kosova dhe KF Liria në Superligë, KF Shkëndija dhe KF Dinamo në Ligën e Parë, si dhe KF Opoja dhe KF Deçani në Ligën e Dytë. Po ashtu, pjesë e këtij takimi ishte edhe përfaqësuesi i KFF Presingu, klub ky i promovuar në Superligën



e futbollit të femrave. Gjatë këtij takimi, në të cilin ishte i pranishëm edhe anëtari i KE-së, Ismajl Ajeti, i pari i FFK-së i

përgëzoi klubet për suksesin e arritur si dhe për angazhimin dhe punën e palodhshme që po bëjnë në përpjekje për të rritur nivelin e

garave në të gjitha kategoritë. Ai po ashtu vlerësoi përpjekjet e klubeve në përmirësimin e cilësisë, derisa vuri në pah se Federata po bën çmos me të gjitha mekanizmat e saj për të krijuar kushte sa më të mira për zhvillimin e futbollit në vendin tonë. Kreu FFK-së, gjithashtu, uroi që këto klube t'i japin një imazh të ri ligave në të cilat do të garojnë dhe të kontribuojnë në ngritjen e mëtejshme të cilësisë së futbollit. Presidenti Ademi shprehu shpresën që klubet e reja të

vazhdojnë të bëjnë përpjekje të mëdha për të përmirësuar veten dhe të promovohen në nivele më të larta të garave. Për t'i promovuar zyrtarisht këto klube në ligat përkatëse, Ademi i dhuroi secilit përfaqësues të klubit flamurin me stemën e FFK-së si shenjë nderimi për suksesin e arritur, derisa i inkurajoi të vazhdojnë të punojnë me përkushtim në të gjitha aspektet, në mënyrë që futbollistëve dhe tifozëve të tyre t'u krijojnë kushte sa më të mira.

Messi mbërrin në Miami, paraqitet të dielën

Miami, 12 korrik - Lionel Messi ka mbërritur në Florida së bashku me familjen për ta nisur një jetë të re në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ylli argjentinas u pa në aeroport derisa me valixhe po e merrte

rrugën drejt vendosjes së tij në Miami. Shtatë herë fituesi i "Topit të Artë" zbarkoi në tokën amerikane me një aeroplan privat në aeroportin e vogël të Mimait. Kampioni i botës do të paraqitet edhe

zyrtarisht nga Inter Miami këtë të diel me një organizim madhështor në "DRV PNK Stadium" në Fort Lauderdale. "Tifozët do të mund ta shijojnë një natë të madhe në fushën e blertë dhe më gjerë",

njoftoi klubi amerikan, duke shtuar se biletat do të jenë falas për këtë ngjarje për ata që do t'i kenë biletat vjetore. Messi pritet ta bëjë debutimin e tij në ekipin e ri më 21 korrik në përballjen e Kupës së Ligës



kundër ekipit meksikan Cruz Azul.

Daniel Ricciardo rikthehet në Formula 1

PERTH, 12 KORRIK - Piloti 34-vjeçar australian Daniel Ricciardo rikthehet në Formula 1 pas vetëm 6 muajsh pushim. Piloti rezervë i Red Bull Racing do të garojë në pjesën e mbetur të sezonit me makinën Alpha Tauri. Ai do ta zërë vendin e Nyck de Vries, që debutonte në

Formula 1. Ricciardo do të jetë pjesë e Red Bullit që nga gara e radhës në Hungari. Skuadra e Alpha Tauri nuk ka mbetur e kënaqur nga paraqitja e De Vries dhe shpeshherë ka deklaruar se priste më shumë prej tij. Ai nuk ka grumbulluar asnjë pikë këtë sezon në 10

garat e para sezonale. Ricciardo, pasi ka mësuar lajmin, ka thënë: "Jam entuziast që rikthehem në pistë me familjen Red Bull". Skuadra e Alpha Tauri është makina satelit e Red Bullit. "Jemi të kënaqur që kemi sërish Danielin në skuadrën tonë.

Nuk kemi dyshime për aftësitë e tij. Na njeh thuajse të gjithë ndaj do të integrohet lehtë", thanë drejtuesit e Alpha Taurit. Daniel Ricciardo ka arritur tetë fitore në karrierën e tij në Formula 1 dhe ka garuar më herët me këtë ekip kur quhej Toro Rosso.



Bayerni, i gatshëm të shesë shtatë lojtarë për ta blerë Kanen

MUNCHEN, 12 KORRIK - Bayern Munchen po planifikon të shesë shtatë lojtarë në mënyrë që të financojë një lëvizje për superyllin e Tottenham Hotspurit, Harry Kane, gjatë këtij afati kalimtar. Bayerni ofroi 80 milionë euro për kapitenin anglez, por presidenti i Tottenhamit, Daniel Levy, e ka refuzuar ofertën e Bayernit pasi vendosi një çmim prej 140 milionë eurosh për 29-vjeçarin. Pavarësisht kësaj, Bayerni po refuzon të dorëzohet dhe thuhet se është i vendosur t'i largojë shtatë lojtarë në një përpjekje për ta rritur buxhetin e tyre të transferimeve të verës. Ndër ata që pritet të shiten është Sadio

Mane, më pak se një vit pasi ai u bashkua me skuadrën e Bundesligës nga Liverpooli për 42 milionë euro. Sipas mediumit "Sky Sports Germany", Bayerni është i gatshëm t'i ndajë rrugët me reprezentuesin e Senegalit për vetëm 17 milionë funte apo 20 milionë euro. Mesfushori austriak Marcel Sabitzer gjithashtu është paralajmëruar të largohet nga klubi "bavarez", me Thomas Tuchel të prirë për të fituar 14 milionë euro nga lojtari. Objektivi i Barcelonës, Benjamin Pavard, është i radhës në listën e fundit, me Bayernin që kërkon rreth 40 milionë euro për mbrojtësin francez. Lojtari më i

shtrenjtë në listën e transferimeve të Tuchel është mesfushori holandez, 21-vjeçari Ryan Gravenberch, i cili pritet t'i ofrojë klubit deri në 42 milionë funte apo rreth 50 milionë euro. Ndërkohë, Bouna Sarr, Alexander Nubel dhe Yann Sommer të gjithë pritet të largohen për tarifa me vlerë më pak se 8.5 milionë funte apo 10 milionë euro. Nëse Bayerni do të arrihte ta shiste secilin lojtar për çmimin e tyre përkatës, kampionët gjermanë do të mblidhnin afërsisht 113 milionë funte (132 milionë euro), të cilat pothuajse me siguri do ta fitonin Kanen nëse ai zgjidhte të largohej nga Londra këtë verë.



Djokoviqi në gjysmëfinale, Wimbledonit dhuron surpriza te femrat

LONDËR, 12 KORRIK - Janë përcaktuar gjysmëfinalistët e parë në Grand Slamin e Wimbledonit, turneu më i rëndësishëm i fushave me bar në tenis. Te meshkujt nuk ka pasur surpriza, teksa serbi Novak Djokoviqi, kampioni në fuqi, fitoi 3-1 me përmbysje ndaj rusit Andrey Rublev. Numri dy në botë gaboi shumë në setin e parë, por më pas ndryshoi strategji dhe nuk e vuri në diskutim fitoren. Përballë Djokoviqit, në gjysmëfinale do të jetë italianin Jannik Sinner, numri tetë në botë, që mundi 3-1 një tjetër rus në çerekfinale, Roman Safiullin.

Te femrat, në ndeshjet e para çerekfinale, nuk kanë munguar surprizat, siç është eliminimi i numrit 1 në botë Iga Swiatek. Tenistja polake u mund 2-1 nga rivalja ukrainase Elina Svitolina,



një sfidë shumë e ekuilibruar, por në fund diferencën e bëri qetë tenistja ukrainase. Kjo humbje rrezikon kreun e renditjes botërore për Swiatek. Në gjysmëfinale shkoi

edhe tenistja çeke Marketa Vondrousova, teksa mposhti 2-1 rivalen amerikane Jessica Pegula, numrin 4 në botë, duke befasuar të gjithë.

SHKURT

Broja: Dua të kthehem përsëri në formë

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Armando Broja, është në planet e Chelseat. Për ta mbështetur më shumë në përgatitjet që ai po kryen gjatë kësaj kohe, klubi londinez i ka bërë një intervistë të shkurtër bomberit kuqezi, ku Broja shprehet i lumtur që ndodhet me ekipin për fazën përgatitore. Mes të tjerave, Broja ka deklaruar se do vetëm të kthehet përsëri në formën më të mirë dhe ta rinisë nga aty. "Është gjë e mirë të jesh përsëri mes djemve, mes grupit të lojtarëve. Ishte një periudhë e gjatë jashtë. Nuk ishte e thjeshtë të qëndroja jashtë i vetëm, por jam i lumtur që jam përsëri me djemtë dhe po i gëzohem", ka thënë Broja.

Pulisiq: Jam shumë i lumtur që jam në Milan

Christian Pulisic është gati ta fillojë aventurën e re me fanellën e Milanit. Sulmuesi amerikan mbërriti në Itali të mërkurën në mëngjes. Faqja zyrtare e Milanit në "Instagram" ka publikuar një video me fjalët e para të folura nga Pulisic menjëherë pas mbërritjes në Milano: "Përhëndetje tifozë të Milanit! Unë jam Christian Pulisic. Sapo kam zbritur në Milano dhe jam shumë i lumtur që jam këtu. Mezi pres të nis punën".

Laporta: Ja pse dështoi marrëveshja me Messin

Presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, është rikthyer të flasë edhe një herë për dështimin e transferimit të Leo Messit në Barcelonë. Ai ka treguar se marrëveshja ishte arritur, por në fund Messi zgjodhi të transferohet tek Inter Miami. "Ne ramë dakord, por çdo gjë ka kohën e vet dhe ndonjëherë ritmet janë të ndryshme. Për kontratën u ra dakord, por kur La Liga na jep autorizimin, babai i tij më thotë se Leo kishte pasur dy vjet të vështira në Paris, se kishte vuajtur shumë dhe tani donte të luante në një ligë me më pak presion. I thashë se ishte krejtësisht e kuptueshme", ka thënë Laporta.

Bayerni refuzohet edhe nga Alvarezi

Bayern Munchen nuk po kalon ditë të mira në tregun e transferimeve, pasi oferta e tyre për Harry Kane është refuzuar nga Tottenham Hotspuri. Ndërsa refuzimi i radhës ka ardhur nga sulmuesi i Manchester Cityt, Julian Alvarez. Klubi kampion i Gjermanisë ka shprehur interesim për të marrë në formë huazimi sulmuesin argjentinas, por ai nuk është i interesuar për një gjë të tillë pasi, siç raportojnë mediet britanike, ai është i interesuar për të qenë pjesë e klubit nga "Etihad" edhe në vitet e ardhshme.

Atletico synon transferimin e Verrattit

Pas 11 vjetësh karrierë të shpenzuar te "gjigantët" francezë të PSG-së, "arkitekti" italian i mesfushës, Marco Verratti, shihet gjithnjë e më larg "parisienëve" këtë merkato verës dhe "aventura" më e re për italianin mund të fillojë në Spanjë. Sipas raportimeve më të fundit nga prestigjiozja spanjolle "Marca", Atletico Madrid shpreson se ulja e pagave nga bordi i kampionëve të Francës mund të ndikojë në largimin e italianit drejt një destinacioni të ri. Italiani është objektivi kryesor i "Los Colchoneros" të Madridit dhe shpresat për transferimin e tij do të forcohen nëse "gjigantët" francezë kryejnë disa transferime të tjera.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “RIONI 020” SH.P.K. me seli në Gjilan, pronar Xhavit Idrizi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812049949 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “RIONI 020” D.O.O. Gnjilane, sa vlasnikom Xhavit Idrizi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812049949 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “RIONI 020” L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Xhavit Idrizi, has come to the decision to quit its business: 812049949 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 12.07.2023 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike**T-23-09**

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e hapësirave
1. Depoja e prodhimit - Industria Kimike
Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë
Data e shpalljes: 12.07.2023
Sqarimi: deri me 21.07.2023
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 21.07.2023
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e shitjes.
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)
Afati i fundit i dorëzimit: 24.07.2023 në 11:00
Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes në Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku industrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>hajdini_b@hotmail.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepcash.com</i>		

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “NKL LIMITED Branch In Kosovo Dega në Kosovë” ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810128753 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “NKL LIMITED Branch In Kosovo Dega në Kosovë” donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810128753 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “NKL LIMITED Branch In Kosovo Dega në Kosovë” has come to the decision to quit its business: 810128753 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Anisa Shahini shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme ASK “American School Of Kosovo, Prishtinë.
- "DE & AD"SH.P.K shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 810098691.
- Leonita Brahimi shpall te pavlefshme dëftesat 6/9 te shkollës fillore “Shaban Idrizi”.
- Arber Ujkani shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme “Xheladin Deda”
- Avni Sadiku shpall te pavlefshme dëftesën klasës se 10-të të shkollës së mesme “Arkitekt Sinani”.
- Merfidete Selmani Preniqi shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme “Gjin Gazulli” Prishtinë.
- Valdete Zhubi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Bekim Komani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e testit të diplomes sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Albin Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat ekl. 10.11.12. dhe diplomën e sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Leonora Avdullahu nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl.10.11.12. sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Mervete Spahija nga Gjakova shpall të pavlefshme dipomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Blendon Muhadri nga Demjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.n.u. “Pjetër Bogdani” Demjan KK Gjakovë.
- Besmir Ibrahimimi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl.I të sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Iliriana Thaqi Bokshiq KK Klinë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X.XI.XII dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” .
- Bujar Haxhibeqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. “Hysni Zajmi” Gjakovë, teknik laborant i biologjisë.



**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales